

KOHA PËR INTEGRIM TË MENÇUR NË NIVEL TË KOMUNITETIT

Sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë nga perspektiva vendore dhe ndërkombëtare



Projekti implementohet nga:



Në partneritet me:



Përgatiti:

Ramadan Ilazi, Dea Fetiu dhe Charlie Hawkes

Mirënjohje:

Autorët dëshirojnë t'i falënderojnë individët e mëposhtëm për kontributin e tyre të çmuar në mbledhjen e të dhënave për këtë raport: Milica Radovanoviq, Gramos Sejdiu dhe Laureta Haziri.

Vërejtje: Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Nxitja e Marrëdhënieve dhe Bashkëpunimit Ndëretnik" (FIERC), implementuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), në partneritet me Iniciativën e Re Sociale (NSI), financuar nga Fondi i Paktit të Stabilitetit i Ministrisë së Jashtme Federale të Gjermanisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin dhe opinionet e Ministrisë së Jashtme Federale të Gjermanisë.

Mbeshtetur nga:



KOHA PËR INTEGRIM TË MENÇUR NË NIVEL TË KOMUNITETIT

**Sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e marrëdhënieve
ndëretnike në Kosovë nga perspektiva vendore dhe
ndërkombëtare**

TABELA E PËRMBAJTJES

Për autorët	1
Përmbledhje ekzekutive	2
Shqyrtimi i sfidave kryesore për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë nga perspektiva lokale	4
Perceptimet e jashtme për gjendjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë	11
Pikëpamja nga Bashkimi Evropian (BE)	11
Pikëpamja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë	13
Pikëpamja e grupeve të ekspertëve ndërkombëtarë për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë	19
Përfundimet kryesore dhe rruga përpara	18
Për nxitjen e bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik (FIERC)	20
Referencat në dokumente	21

PËR AUTORËT



Ramadan Ilazi, është kryesues i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe ka doktoraturë në Politikë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU), Irlandë, dhe një diplomë Master në Studime të Paqes dhe Konfliktit nga Universiteti St. Andrews, Skoci. Në QKSS, Dr. Ilazi është udhëheqës i ekipit të grupit tematik për (de) radikalizimin online dhe offline në Ballkan dhe rajonin e MENA-s në kuadër të projektit hulumtues PAVE të financuar nga Horizonti i BE-së. Publikimet e tij më të fundit e shqyrtojnë konsensusin shoqëror për integrimin euroatlantik dhe ndikimin keqdashës të aktorëve të huaj në Ballkanin Perëndimor. Nga viti 2015 deri në vitin 2016, Dr. Ilazi ka shërbyer si zëvendësministër për Integritime Evropiane në Qeverinë e Kosovës dhe ka qenë aktivisht i angazhuar në procesin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA), dialogun për liberalizimin e vizave dhe zhvillimin e Agjendës së Reformës Evropiane (ERA).



Dea Fetiu, është studente në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Dea ka qenë e përfshirë në QKSS si Asistente Hulumtuese në Programin për Gra, Paqe dhe Siguri, Programin e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Ndërtimin e Komuniteteve Rezistente dhe P/CVE, dhe së fundmi në Projektin FIERC. Para se t'i bashkohej QKSS-së, ajo ka qenë e angazhuar në programet formale të debatit, garën e së drejtës ndërkombëtare të Philip C. Jessup, ndërsa ka qenë e përfshirë me OSHC të tjera kosovare dhe ndërkombëtare, si Lëvizja FOL, Medica Gjakova, Qendra e Debatit , Rrjeti i European Parliament Network.



Charlie Hawkes, iu bashkua Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në shtator të vitit 2022 si praktikant, mbështetur nga programi Erasmus+. Charlie ka diplomë baçelor në Sociologji dhe Kriminologji nga Universiteti Bournemouth. Më parë, Charlie ka punuar si praktikant si Analist i Inteligjencës kundër Terrorizmit në Grupin kundër Terrorizmit dhe është ngritur në pozitë si Zëvendësdrejtues i Ekipit të Komandës për Azi dhe Paqësor (PACOM). Charlie është bashkautor i botimeve në lidhje me gjeopolitikën dhe sigurinë në Azinë Juglindore dhe Afrikën Perëndimore.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron një analizë të perceptimeve vendore dhe ndërkombëtare për gjendjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë. Raporti bazohet në diskutimet që janë zhvilluar në një fokus grup me të rinjtë kosovarë, si dhe në intervistat personale të gjysmëstrukturuara me akterët kyçë nga shoqëria civile dhe sektori publik. Qëllimi i këtij raporti është që të ndihmojë për të kuptuar më mirë se cilat janë disa nga sfidat e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, si dhe mundësitë për avancimin e bashkëpunimit ndëretnik.

Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike pas pavarësisë së saj në vitin 2008 dhe përmes përkushtimit të saj për ta zbatuar Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të njohur si "Plani i Ahtisaarit", i cili Kosovën e përkufizon si "shoqëri shumetnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respekt të plotë për sundimin e ligjit dhe nivelin më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht".

Përmirësimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndëretnik nuk shihet si prioritet për partitë politike në Kosovë, gjë që i përkeqëson tensionet dhe mosbesimin mes komuniteteve shumicë dhe joshumicë. Përveç kësaj, partitë politike në Kosovë, në përgjithësi, kanë një hendek serioz me jetën e përditshme me të cilën ballafaqohet komuniteti dhe nuk arrijnë të kuptojnë se ka shumë emërues të përbashkët midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës sa u përket sfidave me të cilat përballen, siç janë papunësia, nepotizmi dhe mundësia e qasjes në shërbime publike dhe cilësia e tyre.

Ekziston një dallim midis gjendjes së marrëdhënieve ndëretnike dhe bashkëpunimit në veri të Kosovës, i cili s'do mend se është subjekt i tensioneve të shtuara, krahasuar me jugun e vendit, i cili është relativisht më i qetë. Në jug të Kosovës, komunitetet kanë më shumë përvojë në bashkëpunim dhe bashkëjetesë, si dhe janë më rezistente ndaj radikalizimit etnopolitik, në krahasim me veriun. Zbatimi i formulave të ndarjes së pushtetit në kuadër të procesit të decentralizimit është njëri nga faktorët kontribuues që komunitetet joshumicë në jug kanë qenë më të mbështetura ndaj politikave integruese.

Sfidë e madhe për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë është mungesa e ndërveprimeve dhe komunikimit të mjaftueshëm midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Në këtë aspekt, shoqëria civile ka shënuar intensitet më të lartë për të lehtësuar bashkëpunimin krahasuar me akterët e tjerë.

Ekziston një potencial i pashfrytëzuar për t'i kultivuar marrëdhëniet ndëretnike përmes bashkëpunimit ekonomik, në mënyrë që të trajtohen problemet kryesore si për shqiptarët e Kosovës, ashtu edhe për serbët e Kosovës, e që janë papunësia dhe mungesa e mundësive për të rinjtë, si dhe përmes mobilizimit të komunitetit për t'i avancuar interesat e përbashkëta.

Në një kontekst kur institucionet publike nuk pranohen plotësisht nga serbët e Kosovës, organizatat e shoqërisë civile mbeten akterët kryesorë që angazhohen për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, por qeveria nuk duket se ka nivel adekuat të bashkëpunimit me këto organizata, përveç kontributit të kufizuar të tyre në procesin e

politikëbërjes. Sidoqoftë, qeveria ka tendencë të mendojë se organizatat joqeveritare udhëhiqen nga agjendat personale dhe donatorët kur është fjala për punën e tyre në marrëdhëniet ndëretnike.

Në mesin e komunitetit shqiptar të Kosovës ekziston një perceptim i përhapur se komuniteti serb në Kosovë, e veçanërisht përfaqësuesit politikë, janë të kontrolluar fuqishëm nga Beogradi dhe kjo çon në mungesën e besimit, i cili është një faktor tjetër i rëndësishëm që u kontribuon tensioneve ndëretnike dhe bashkëpunimin të kufizuar.

SHQYRTIMI I SFIDAVE KRYESORE PËR MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMIN NDËRETNIK NË KOSOVË NGA PERSPEKTIVA LOKALE

Ky kapitull ofron një pasqyrë të përgjithshme të sfidave kryesore nga këndvështrimi i politikëbërësve vendorë dhe aktivistëve të shoqërisë civile, të cilat e minojnë potencialin e Kosovës si shoqëri shumetnike. Argumenti kryesor i këtij kapitulli është se Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm, veçanërisht përmes legjislacionit dhe masave të tjera të politikave për promovimin e multiethnicitetit dhe nxitjen e bashkëpunimit ndëretnik në vend, por ka mangësi serioze sa i përket zbatimit të përgjithshëm si dhe cilësisë së zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve joshumicë në Kosovë. Krahas kësaj, ky raport i shkurtër tregon se gjendjes së marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë i jep trajtë diskursi i liderëve politikë, kështu që tensionet e shtuara etnike në vend nxiten ose vijnë pas fjalimeve të liderëve politikë nga Kosova dhe Serbia.

Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike pas pavarësisë së saj në vitin 2008 dhe përmes përkushtimit të saj për ta zbatuar Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, që zakonisht quhet “Plani i Ahtisaarit”, i cili Kosovën e përkufizon si “ shoqëri shumetnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respekt të plotë për sundimin e ligjit dhe nivelin më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht”¹. Megjithatë, përkundër progresit të dukshëm, marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë janë të brishta dhe në vitin e fundit veçanërisht janë karakterizuar me tensione të shtuara dhe dhunë në disa raste, veçanërisht në veri të Kosovës, ku gjenden katër komuna me shumicë serbe (Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zubin Potoku dhe Zveçani). Si një nga faktorët që u ka kontribuar tensioneve etnike të shtuara kohëve të fundit në Kosovë shihet dështimi i institucioneve publike dhe liderëve politikë në Kosovë për t’i dalluar fjalimet dhe mesazhet e tyre të menduara për Serbinë nga ato për serbët e Kosovës.² Me fjalë të tjera, duket se retorika shpeshherë negative e liderëve politikë të Kosovës ndaj Serbisë përfshinë edhe komunitetin serb në Kosovë, ose të paktën kështu perceptohet kjo retorikë nga ky komunitet. Serbët e Kosovës shpesh ndihen të sulmuar kur liderët politikë në Kosovë drejtojnë mesazhe politike kundër Serbisë. Sipas aktivistëve të shoqërisë civile që i monitorojnë marrëdhëniet ndëretnike rregullisht, në komunitetin serb në Kosovë është i përhapur perceptimi se liderët politikë e barazojnë “Serbinë me serbët e Kosovës, çfarë po i kontribuon përkeqësimit serioz të marrëdhënieve ndëretnike, ndërsa, në anën tjetër, nuk kemi sjellje të dobishme në anën e përfaqësuesve politikë serbë të Kosovës, përkatësisht Listës Serbe, të cilët mendojnë se e

1 Shih: Dispozitat kryesore të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, marrë nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BF-CF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FFs9%7D/%20S2007%20168.pdf>, fq. 6

2 Intervistë personale me një përfaqësues të lartë të shoqërisë civile. Mitrovicë e Veriut, 23 dhjetor 2022.

kanë pothuajse të pamundur të bisedojnë me Qeverinë e Kosovës në mënyrë konstruktive.”³ Kjo e shpërfaqë qartë brishtësinë e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, të cilat duket se varen nga disponimi dhe ndjenjat personale të liderëve të të dyja vendeve. Me fjalë të tjera, pa normalizim serioz të marrëdhënieve në nivel politik midis përfaqësuesve të qeverisë nga Serbia dhe Kosova, çdo përparim në terren, në nivel të komunitetit, mund të minohet apo madje edhe të zhbëhet.

Përmirësimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndëretnik nuk është prioritet për partitë politike në Kosovë, gjë që i përkeqëson tensionet dhe mosbesimin midis komuniteteve shumicë dhe joshumicë. Përveç kësaj, partitë politike në Kosovë, në përgjithësi, e kanë një hendek serioz me jetën e përditshme me të cilën përballet komuniteti dhe nuk arrijnë të kuptojnë se ka shumë emërues të përbashkët midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës për sa u përket sfidave me të cilat përballen, siç janë papunësia, nepotizmi dhe mundësia e qasjes në shërbime publike dhe cilësia e tyre. Sipas një analisteje kosovare me përvojë në qeveri, “qasja e partive politike nga të dyja palët është e largët, nuk i prekë problemet reale të komunitetit dhe nuk e promovon bashkëpunimin ndëretnik”⁴. Ngjashëm, një zyrtar nga komuna e Mitrovicës së Jugut, i cili është intervistuar për këtë raport, shpreh pikëpamje pesimiste për rolin që luajnë partitë politike në kontekstin e marrëdhënieve ndëretnike, duke thënë se “politika po na mbytë, komunitetet nuk po mund të ‘ulen’ së bashku”⁵. Kjo tregon se, nga këndvështrimi i disa qytetarëve, politika dhe partitë politike në përgjithësi janë bërë pengesë për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe organizimin e komuniteteve. Dështimi i partive politike për ta trajtuar bashkëpunimin ndëretnik si prioritet rezulton me humbje të mundësive, humbje të talentit dhe potencialit për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim. Për më tepër, hendeku midis partive politike në Kosovë dhe komunitetit krijon cenueshmëri ndaj përpjekjeve për t’i radikalizuar komunitetet përgjatë vijave etnike apo fetare. Udhëheqësit politikë shpesh e shfrytëzojnë brishtësinë e marrëdhënieve ndëretnike për t’i çuar përpara qëllimet e tyre populiste, posaçërisht kur nuk arrijnë të realizojnë reformat e brendshme. Politikanët shihen si të painteresuar për të pasur kontakte dhe shkëmbime të rregullta me pjesëtarët e komuniteteve të tjera. Përpjekjet e rralla, siç është rasti i pjesëmarrjes së kryetarit të Pejës në ceremonitë fetare ortodokse, janë pritur mirë nga komunitetet joshumicë dhe ndihmojnë në mbylljen e hendekut midis këtyre dy komuniteteve. Sipas një eksperti, nismat e tilla nga ana e liderëve ua hapin rrugën qytetarëve të tjerë që të ndërveprojnë dhe krijojnë bashkëpunime të përbashkëta me të gjitha grupet e ndryshme etnike që jetojnë në të njëjtin mjedis, ndërsa rastet e tjera kur liderët politikë shihen si hezitues për të bashkëpunuar me komunitetet joshumicë japin shembull të keq për t’u ndjekur nga qytetarët.

3 IPO aty, (23 dhjetor 2022.)

4 Personal interview with Kosovo analyst. Prishtina: November 3, 2022

5 Personal interview with a municipal official from Municipality of Mitrovica South. Mitrovica South: December 19, 2022

CILAT KONSIDERONI SE JANË PENGESAT KRYESORE PËR MARRËDHËNIE MË TË MIRA NDËRETNIKE NË KOSOVË?

“Komuniteti serb i Kosovës që i mohon krimet e luftës dhe komuniteti shqiptar i Kosovës që përpiqet t’i përdorë krimet e luftës për të fituar avantazh politik në negociatat që supozohet se kanë të bëjnë më së shumti me të drejtat e komunitetit serb të Kosovës është ajo që me të vërtetë po i trazon ujërat. Pra, kjo është ajo që unë e shoh si pengesë kryesore (ekstrakt nga intervista me një serb të Kosovës nga veriu i Kosovës)”.

“Sa u përket marrëdhënieve me serbët, shumë gjëra janë të tensionuara me dialog, narrativat e palës serbe dhe asaj kosovare po e tensionojnë situatën edhe më shumë dhe po i dëmtojnë marrëdhëniet ndëretnike (analisti kosovar)”.

Ekziston një dallim midis gjendjes së marrëdhënieve ndëretnike dhe bashkëpunimit në veri të Kosovës, i cili nuk do mend se është subjekt i tensioneve të shtuara, krahasuar me jugun e vendit, i cili është relativisht më i qetë. Në jug të Kosovës, komunitetet kanë më shumë përvojë në bashkëpunim dhe bashkëjetesë dhe janë më rezistente ndaj radikalizimit etnopolitik, krahasuar me veriun. Zbatimi i formulave të ndarjes së pushtetit në kuadër të procesit të decentralizimit është njëri nga faktorët kontribuues se komunitetet joshumicë në jug kanë qenë më mbështetëse ndaj politikave integruese. Serbët e Kosovës që jetojnë në jug të Kosovës janë më të integruar në shoqërinë kosovare, krahasuar me serbët e veriut, por në periudhën e fundit edhe ata kanë qenë nën presion: “E pamë në fund të gushtit, kur do të viheshin në zbatim politika të reja për targat e automjeteve dhe dokumentet, se si mund të ndryshojë situata brenda natës. Dhe kjo është për shkak se ajo ndoshta manipulohet nga politikanët, ndërsa individët e dinë se sa larg mund të shkojnë, por janë po ashtu nën presion shumë, shumë të madh. ° Për shkak të mungesës së ndërveprimit, qytetarët e Kosovës nuk janë të vetëdijshëm për çështjet me të cilat përballen grupet e tjera si dhe për kushtet dhe mjedisin në të cilin ata jetojnë. Kjo i bën qytetarët veçanërisht të ndjeshëm ndaj ndërtimit të perceptimeve të tyre duke u bazuar në narrativat e kaluara, ose retorikën e përdorur nga liderët politikë në të dyja vendet, dhe kjo i bën ata më të ndjeshëm ndaj dezinformatave dhe informatave me implikime polarizuese. Perceptimet që zhvillohen në këtë mënyrë janë në shumicën e rasteve diametralisht të kundërta me realitetin, duke e bërë kështu distancën etnike relativisht të pabazuar. Mungesa e kontakteve që çojnë në perceptime të pabazuara është po ashtu evidente në gjetjet e hulumtimeve në terren, të cilat tregojnë se, edhe pse jetojnë në të njëjtat komuna, serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës kanë perspektiva tejet të ndryshme për diskriminimin në baza etnike që ndodh në Kosovë. Duke marrë parasysh se narrativat për njëri-tjetrin luajnë rol të madh në formimin e marrëdhënieve më të mira ndëretnike, duhet të planifikohen më shumë aktivitete ndëretnike si nga institucionet lokale, ashtu edhe ato qendrore, në mënyrë që të lehtësohen kontaktet midis njerëzve nga të dyja komunitetet.

° Intervistë personale me drejtorin e një organizate joqeveritare që merret me avancimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, Prishtinë, 21 tetor 2022.

Sfidë e madhe për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë është mungesa e ndërveprimeve dhe komunikimit të mjaftueshëm midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës, ndonëse me përjashtim të shoqërisë civile, e cila ka shënuar intensitet më të lartë të bashkëpunimit krahasuar me sektorët e tjerë. Edhe kjo mungesë e ndërveprimit apo shkëmbimit midis këtyre dy komuniteteve i kontribuon mungesës së vetëdijes në nivel të komunitetit, se sa shumë sfida të përditshme janë të përbashkëta për të dyja komunitetet (si p.sh., korrupsioni, papunësia, cilësia e shërbimeve publike, etj.), e të cilat potencialisht mund të mundësojnë më shumë bashkëpunim. Ky fakt, po ashtu, i kontribuon edhe mungesës së bashkëndjesisë dhe mirëkuptimit për vuajtjet dhe përvojat e cilitdo komunitet. Edhe komuniteti i donatorëve i ka dhënë prioritet financimit të aktiviteteve dhe ndërveprimeve për shkëmbim midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve nga Serbia, por vërehet se ka më pak mbështetje për organizime të shkëmbimit midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Mungesa e ndërveprimeve ka efekt veçanërisht negativ në shoqëri, meqë komunitetet mësojnë të jetojnë krejtësisht të ndara dhe harrojnë se si të ndërveprojnë. Udhëheqësit e shoqërisë civile argumentojnë se “nuk ka aq shumë ndërveprime sa ka pasur në të kaluarën dhe kjo është për të ardhur keq, ndërsa mendoj se edhe njerëzit i kanë harruar ato, sepse ne i kemi dërguar një grup studentësh në manastirin e Graçanicës vitin e fundit dhe njëra nga arsyet pse kemi dashur t’i dërgojmë në kishë ka qenë që njerëzve t’ua kujtonim se një herë e një kohë në këto kisha, kur i kanë pasur festat vjetore dhe festat fetare të tyre, komunitetet e tjera kanë ardhur pjesërisht sepse ka pasur shumë besëtytni rreth tyre, p.sh. është menduar se në to është gjetur shërim, ka pasur të drejta të fertilitetit, të gjitha këto gjëra.”⁷ Përveç kësaj, mbështetja nga institucionet publike është e kufizuar për organizimet e shkëmbimit, ndonëse me disa përjashtime. Sipas aktivistëve të shoqërisë civile që janë intervistuar për këtë raport, ka raste kur institucionet komunale i mbështesin ngjarjet që për qëllim kanë promovimin e multietnicitetit dhe ndërveprimeve: “Në komunat vërtetë shumetnike, siç janë Prizreni dhe Mitrovica e Veriut, do të thosha se janë bërë disa përpjekje nga ana e autoriteteve komunale për t’i mbështetur nismat sociale, por nuk jam i sigurt nëse ato janë mjaftë të dukshme”⁸. Një fushë veçanërisht shqetësuese sa i përket mungesës së ndërveprimeve ka të bëjë edhe me shkollat.

Ekziston një potencial i pashfrytëzuar për t’i kultivuar marrëdhëniet ndëretnike përmes bashkëpunimit ekonomik dhe përmes mobilizimit të komunitetit për t’i avancuar interesat e përbashkëta, në mënyrë që të trajtohen problemet kryesore si për shqiptarët e Kosovës, ashtu edhe për serbët e Kosovës, të cilat janë papunësia dhe mungesa e mundësive për të rinjtë. Nxitja e bashkëpunimit ndëretnik përmes mundësive ekonomike dhe ndërtimi i konsensusit shoqëror për sfidat e përbashkëta është gjithashtu ajo që mund të kuptohet si ‘integrim i mençur’. Pjesëmarrësit e një fokus grupi me të rinj shqiptarë të Kosovës, që është organizuar në kuadër të projektit FIERC për këtë raport, kanë shfaqur mbështetje të madhe për bashkëpunimin ekonomik apo për aktivitete që i bashkojnë komunitetet përmes projekteve ekonomike⁹. Mendim të ngjashëm kanë pasur edhe ekspertët që janë intervistuar për këtë raport, kur janë pyetur se cilat fusha i shohin si potencialin më të madh për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike:

7 Po aty, (21 tetor 2022)

8 Intervistë personale me një përfaqësues të lartë të shoqërisë civile. Mitrovicë e Veriut, 23 dhjetor 2022..

9 Grupi i fokusit i projektit FIERC me të rinjtë shqiptarë të Kosovës, Prishtinë, 25 tetor 2022.

“Shoh shpresë për përmirësim vetëm në fushën ekonomike. Mendoj se vetëm me zhvillim ekonomik mund të bëjmë diçka për ta avancuar bashkëpunimin ndëretnik. Përmes zhvillimit ekonomik, ne mund ta trajtojmë çështjen e varësisë ekonomike të serbëve të Kosovës nga Serbia dhe të krijojmë mundësi që ata të punojnë në Kosovë dhe ta kenë ndjenjën e komunitetit, përmes së cilës mund të përmirësohet bashkëpunimi ndëretnik”¹⁰. Mundësitë e tilla do të përfshinin p.sh. mbështetjen për bizneset e reja shumëtnike, bizneset e vogla me staf shumëtnik dhe ofrimin e trajnimeve profesionale për të rinjtë shqiptarë dhe serbë të Kosovës. Përveç kësaj, bashkëpunimi ndëretnik mund të përmirësohet duke i mbështetur nismat qytetare për t’i trajtuar problemet me interes të përbashkët, siç është rasti i vitit 2019, kur shqiptarët dhe serbët e Kosovës protestuan kundër dëmeve të shkaktuara nga ndërtimi i një hidrocentrali në lumin Lepenc, komuna e Shtërpocës¹¹. Ky rast ilustron se sa mirë mund të veprojnë qytetarët në komunitete të ndryshme etnike kur i adresojnë problemet që ndikojnë në ta në mënyrë të barabartë.

Në një kontekst kur institucionet publike nuk pranojnë plotësisht nga serbët e Kosovës, organizatat e shoqërisë civile mbeten akterët kryesorë që angazhohen për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, por qeveria nuk duket se ka nivel adekuat të bashkëpunimit me këto organizata, përveç kontributit të kufizuar të tyre në procesin e politikëbërjes. Po ashtu, qeveria mendon se organizatat joqeveritare udhëhiqen nga agjendat personale dhe donatorët kur është fjala për punën e tyre në marrëdhëniet ndëretnike. Organizatat e shoqërisë civile (organizatat joqeveritare) kanë qenë shtytësi kryesor i ndryshimit afirmativ në komunitete të ndryshme në Kosovë, të mbështetura në masë të madhe nga komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë. Aktorët ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, gjithashtu janë të prirë që shoqërinë civile ta shohin si “lojtarin më konstruktiv”¹². në këtë fushë. Vetë përfaqësuesit e shoqërisë civile po ashtu pohojnë se puna që ata e bëjnë në promovimin e marrëdhënieve ndëretnike është punë e vështirë, e cila në disa raste mund të sjellë edhe reagime nga publiku, i cili këto organizata mund t’i shohë si ofertues në emër të bashkësisë ndërkombëtare. Një fushë në të cilën organizatat e shoqërisë civile kanë kontribuar dukshëm është normalizimi i dialogut për sfidat ndaj marrëdhënieve më të mira ndëretnike në Kosovë. Në këtë kontekst, puna që Iniciativa e Re Sociale (NSI) e ka bërë me projektin ‘Kolektivi Kosovar’ është veçanërisht e rëndësishme për t’i trajtuar stereotipet, por edhe për të folur me vendosmëri për çështjet siç janë trashëgimia kulturore, asociacioni/komuniteti i komunave me shumicë serbe etj. Një kritikë ndaj organizatave të shoqërisë civile që punojnë në marrëdhëniet ndëretnike është se ato janë të prira të punojnë me të rinjtë dhe me individë shumë liberalë që normalisht do t’i mbështesin marrëdhëniet më të mira ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Me fjalë të tjera, shihet se organizatat e shoqërisë civile më së shumti bisedojnë me njëra-tjetrën kur bëhet fjala për çështjet e egra të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe shihen si pa guxim për t’i përfshirë në dialog grupet e tjera të shoqërisë që mund të kenë mendim tjetër. Nga këndvështrimi i qeverisë, shoqëria civile ose organizatat joqeveritare “më së shumti punojnë për interesa personale, duke përfshirë serbët dhe shqiptarët. Në

10 Intervistë personale me analistin kosovar, Prishtinë, 3 nëntor 2022

11 Lexoni “Serish protestojnë shqiptarë e serbë në Shtërpocë kundër ndërtimit të hidrocentralit” nga Koha Ditore, <https://www.koha.net/kosove/171735/serish-protestojne-shqiptare-e-serbe-ne-shterpce-kunder-ndertimit-te-hidrocentralit/>

12 Intervistë personale me një ekspert ndërkombëtar, Prishtinë, 21 tetor 2022.

OJQ-të shoh që shpeshherë i përdorin shkaqet e bashkëpunimit apo pajtimit vetëm për t'u përfaqësuar në takime të nivelit të lartë, në përfaqësitë në Bruksel dhe në vende të tjera, e jo sepse duan të bëjnë diçka që u ndihmon atyre dhe që e përmirëson situatën. E shohim që sa vite këta njerëz janë marrë me bashkëpunimin ndëretnik, por ende nuk është rregulluar asgjë, gjendja e këtij bashkëpunimi është krejtësisht e pasuksesshme¹³. Përfaqësuesit e shoqërisë civile që punojnë në veri të Kosovës argumentojnë se ajo që po bëjnë OJQ-të "nuk mjafton aspak" por se "nuk mund ta mbajnë mbi supe tërë peshën dhe kjo po tregon, në muajt e fundit, se çfarëdo që kanë punuar OJQ-të në prej vitesh mund të çmontohet brenda pak orësh, jo ditësh, por brenda pak orësh, me veprime politike përçarëse. Pra, përfundimi im kryesor këtu do të ishte se OSHC-të e bëjnë maksimumin për pajtimin; ato e bëjnë punën më të mirë për pajtimin, por edhe punën më pak të qëndrueshme dhe të prekshme, për fat të keq"¹⁴. Diskutimet në grupin e fokusit të FIERC-it tregojnë se shoqëria civile nga të rinjtë shqiptarë të Kosovës shihet si "e vetmja mënyrë në të cilën ata mund të komunikojnë me serbët e Kosovës"¹⁵. Një qasje kyçe e shoqërisë civile që është dëshmuar e rëndësishme për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë përfshin aktivitetet e vetëdijesimit dhe informimit në mesin e komuniteteve joshumicë për të drejtat e tyre dhe për mbrojtjen ligjore kundër diskriminimit.

Në mesin e komunitetit shqiptar të Kosovës ekziston një perceptim i përhapur se komuniteti serb në Kosovë, e veçanërisht përfaqësuesit politikë, janë të kontrolluar fuqishëm nga Beogradi dhe kjo çon në mungesën e besimit, i cili është një faktor tjetër i rëndësishëm që u kontribuon tensioneve ndëretnike dhe bashkëpunimin të kufizuar. Viteve të fundit, por sidomos që nga viti 2018, diskursi politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me gjasë ka filluar të përkeqësohet në një nivel tjetër, gjë që e ka përkeqësuar mungesën e besimit ndërmjet liderëve politikë, që pastaj ka ndikuar edhe në perceptimet lokale ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Sipas një analisteje kosovare me përvojë qeveritare, "përderisa në krye të tij është [presidenti serb Aleksandar] Vuçiqi, nuk do të ketë bashkëpunim midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, pavarësisht çdo lloj marrëveshjeje për normalizim; thjesht nuk do të ketë normalizim ndëretnik"¹⁶. Në anën tjetër, përfaqësuesit e shoqërisë civile që punojnë në veri të Kosovës po ashtu e shohin qeverinë e Kosovës si të përfshirë në akte që i cenojnë marrëdhëniet ndëretnike, "si rezultat i retorikës shumë të dëmshme që vjen nga zyrtarët e qeverisë së Kosovës"¹⁷. Arsyeja kryesore për këtë perceptim është se si silltet Lista Serbe, parti politike parlamentare në Kosovë, duke treguar vazhdimisht se i është besnike vetëm Beogradit, por edhe përmes përpjekjeve për ta kontrolluar dhe monopolizuar veprimin politik dhe pjesëmarrjen e komunitetit serb në Kosovë.

Having discussed the local perspectives of challenges that hinder interethnic relations and cooperation in Kosovo, the next section analyses the perspectives from the international state and non-state actors.

13 Intervistë personale me analistin kosovar, Prishtinë, 3 nëntor 2022.

14 Intervistë personale me një përfaqësues të lartë të shoqërisë civile, Mitrovicë e Veriut, 23 dhjetor 2022.

15 Grupi i fokusit i projektit FIERC me të rinjtë shqiptarë të Kosovës, Prishtinë, 25 tetor 2022.

16 Intervistë personale me analistin kosovar, Prishtinë, 3 nëntor 2022.

17 Intervistë personale me një përfaqësues të lartë të shoqërisë civile, Mitrovicë e Veriut, 23 dhjetor 2022.

Dialogu i normalizimit i ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë luan rol vendimtar në gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe që nga viti 2011, kur ka filluar, në shumicën e rasteve i ka kontribuar përmirësimit të bashkëpunimit ndëretnik, ndërsa në disa raste ka luajtur rol mjaft negativ. Sa i përket kontributit, disa nga marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut dhe zbatimi efektiv i tyre e kanë përmirësuar gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike, në radhë të parë duke ua lehtësuar qasjen grupeve joshumicë në institucione.¹⁸ Sipas një përfaqësuesi të shoqërisë civile, "ideja që dialogu ua ka treguar të dyja palëve vlerën e bashkëpunimit për zhvillim – e që vlen edhe për marrëdhëniet ndëretnike – është një aspekt tjetër në të cilin ai ka bërë një punë të mirë".¹⁹ Në anën tjetër, shumica e ngërçeve të dialogut të nxitura politikisht që janë paraqitur gjatë viteve të fundit kanë qenë të dëmshme për gjendjen e serbëve të Kosovës dhe për marrëdhëniet ndëretnike, meqë kanë bërë që publiku dhe liderët ta zhvendosin retorikën e tyre në një retorikë që është më shumë nacionaliste dhe përçarëse ndërmjet të dy komuniteteve. Sipas rezultateve të Anketës së Hulumtimit në Terren të FIERC-it, kjo retorikë publike, e lidhur me dialogun, veçanërisht në vitin e fundit, është perceptuar si tejet armiqësore nga serbët e Kosovës. Kjo retorikë i kontribuon përkeqësimit të gjendjes së marrëdhënieve ndëretnike, duke e ngritur shkallën e urrejtjes dhe mosbesimit midis komuniteteve. Sipas intervistës me një ekspert, dialogu është shumë i rëndësishëm kur bëhet siç duhet, por mund të imponojë edhe ndryshime të mëdha, veçanërisht për komunitetet joshumicë në të dyja vendet, që vijjnë bashkë me procesin dhe që janë dëshmuar të dëmshme. Megjithatë, procesi i dialogut, edhe me ngecjet e mëdha të tij të viteve të fundit, është shumë i rëndësishëm dhe e vetmja platformë përmes së cilës mund të arrihet marrëveshje për normalizimin e situatës midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës.

Pas shqyrtimit të perspektivës lokale për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, me fokus në sfidat, kapitulli në vijim i sintetizon informatat nga raportet ndërkombëtare për këtë temë. Është e rëndësishme që ta kemi një hartë të dy perspektivave, në mënyrë që Kosova të avancojë në obligimet e saj për të kultivuar shoqëri shumetnike në vend.

18 Intervistë personale me një ekspert ndërkombëtar, Prishtinë, 21 tetor 2022.

19 Grupi i fokusit i projektit FIERC me të rinjtë shqiptarë të Kosovës, Prishtinë, 25 tetor 2022.

PERCEPTIMET E JASHTME PËR GJENDJEN E MARRËDHËNIEVE DHE BASHKËPUNIMIN NDËRETNIK NË KOSOVË

Ky kapitull ofron një përmbledhje të pikëpamjeve të Bashkimit Evropian (BE-së), Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA-së) dhe të grupeve të ekspertëve ndërkombëtarë për gjendjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë. Qëllimi i këtij kapitulli është që të ofrojë një pasqyrë të sfidave kryesore për marrëdhënie më të mira ndëretnike në Kosovë nga këndvështrimi i akterëve ndërkombëtarë.

Komisioni Evropian ka identifikuar disa përmirësime në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë midis viteve 2019 dhe 2022, veçanërisht efikasitetin hetimor të Institucionit të Ombudspersonit në lidhje me diskriminimin në vendin e punës dhe zbatimin e ligjeve të veçanta për të drejtat e njeriut sipas normave të BE-së. Megjithatë, ka ende boshllëqe të mëdha që nuk janë trajtuar sa duhet, siç është p.sh. përfaqësimi i ulët i komuniteteve joshumicë në sektorin publik për shkak të mungesës së qasjes në vende të punës dhe mundësive të kufizuara për këto komunitete.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës duket se mbajnë qëndrim të ngjashëm me BE-në sa u përket marrëdhënieve ndëretnike, me një përmirësim të përgjithshëm në hapat që janë bërë për ta forcuar pajtimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, por me mungesë të zbatimit të legjislacionit përkatës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar mungesës së të drejtave që u ofrohen të kthyerve të pakicave etnike dhe ndikimit negativ që komunitat me shumicë serbe në Kosovë mund ta kenë në tërë komunitetin e pakicës serbe në Kosovë.

Organizatrat e grupeve të ekspertëve ndërkombëtarë theksojnë se mungesa e zbatimit të legjislacionit përkitazi me integrimin ndëretnik është çështja kryesore që ndikon në marrëdhëniet ndëretnike. Përveç kësaj, ASK-ja sugjeron që, për të siguruar që marrëdhëniet ndëretnike ta arrijnë një shkallë të pajtimit dhe bashkëpunimit, qeveria e Kosovës duhet t'i njohë komunitetet pakicë si kosovarë, e jo si "të huaj".

PIKËPAMJA NGA BASHKIMI EVROPIAN (BE)

